REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr._____Prot. Tiranë, më 17.11.2026

MBLEDHJA Nr. 50,
Datë 19.11.2026, ora 13:30
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*"; (ii) nenit 9, të "*Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë* (ERE)", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të "*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 19.11.2026, ora 13:30,** do të zhvillohet mbledhja nr. 50 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Bordit të ERE-s nr. 48, datë 06.11.2026.

2. Mbi kërkesën e shoqërisë "SHPËRDHAZA ENERGJI" shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

3. Mbi kërkesën e shoqërisë "EURON SOLAR - PV" shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 155, datë 07.10.2020 "*Mbi licencimin e shoqërisë "MATEO&CO" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike*", i ndryshuar.

5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 150, datë 28.04.2023 "*Mbi modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P të shoqërisë "Kurum International" sh.a per prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i "Shkopet"*.

6. Mbi kërkesën e shoqërisë "Sun Energy Solutions" shpk për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Mbi kërkesën e shoqërisë "ES 2019" shpk për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

8. Mbi kërkesën e shoqërisë "SPV Blue 1" shpk për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

9. Mbi kërkesën e shoqërisë "NAD Investement" shpk për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” shpk për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

11. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI

Petrit AHMETI